

V E N D I M
Nr. 635, datë 13.12.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 605, DATË 13.10.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KURSET E FORMIMIT PROFESIONAL,
TË KUALIFIKIMIT E SPECIALIZIMIT NË AKADEMINË E POLICISË
"ARBEN ZYLYFTARI""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 pika 4, 63, pika 5 të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", të neneve 10 pika 1, 12, pika 2, 13, pika 2, 15, pika 3 dhe 16 të ligjit nr. 8643, datë 20.7.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 605, datë 13.10.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "a" e pikës 3.2 ndryshohet si vijon:

"a. Për rolin bazë: - Nga agjent i parë në asistent dhe nga asistent i parë në kryeasistent nga 1 deri në 2 javë."

2. Shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 3.3 ndryshohen si më poshtë vijon:

"a. Për rolin bazë nga 1 deri në 6 javë.

b. Për rolin e mesëm nga 1 deri në 4 javë.

c. Për rolin e lartë nga 1 deri në 2 javë."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano